



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.393/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Ardian Elshani, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025, me datë 07.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.393/2025, e datës 05.11.2025, e parashtruar nga Ardian Elshani kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 05.11.2025, ka pranuar ankesën ZL.Anr.393/2025, nga Ardian Elshani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik PDK, në të cilën pretendon se pasi që është njoftuar me rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të 12 Tetorit 2025 nga KQZ-ja është i pakënaqur me rezultatin e numërimit sepse është i bindur se është votuar nga votues potencial në regjistrin e votuesve në vendvotimet: Lagjen Bresje në Fushë Kosovë, vendvotimi Shkolla Fillore "Daut Bogujevci, Klasa 0909/04 dhe Klasa 0909/02 ku ankuesi pretendon se i ka së paku 50 vota të cilat i mungojnë dhe të njëjtat ja kanë konfirmuar që e kanë votuar votuesit e këtyre vendvotimeve por edhe votues të tjerë të shënuar më numra personal në këtë ankesë andaj sipas tij është shumë e lehtë që të verifikohen vendvotimet dhe të hapen kutitë e numërimit pasi që është devijuar vullneti i votuesve për të dhe përmes rinumërimit vullneti duhet të kthehet në vendin e vet ku kanë votuar votuesit.

Parashtruesi i ankesës gjithashtu pretendon se në Qendrën e Votimit Bardhi i Madh në shkollën "Zenel Salihu" në rezultatin përfundimtar zgjedhor i kanë dalur vetëm dy vota kurse së paku 6 votues të vendvotimeve 0904/0, 0904/02 dhe 0904/03 por që sipas ankuesit komisionerët e vendvotimit ose i kanë numëruar gabimisht ose janë manipuluar në ndikimin e brendshëm dhe të jashtëm për pasojë prapë është devijuar vullneti i qytetarëve, veprime dhe gabime vendimtare që sipas parashtruesit të ankesës nuk e ka fituar mandatin për më pak se

20 vota. Ankuesi ankesën për mungesë të rezultatit të vërtetë e mbështet edhe mbi bazën e takimeve, lobimit dhe përkushtimit të tij politik gjatë fushatës zgjedhore. Andaj, duke u bazuar në këto rrethana, parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP që të urdhëroj KQZ-në që të bëjë rinumërimin e votave në këto vendvotime.

Si prova në ankesë, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografitë e takimeve e datës 03.10.2025 dhe 08.10.2025 me pjesëmarrje masive deri 150 vetë dhe votuesit e numrat personal të tyre që sipas parashtruesit të ankesës janë të gatshëm të vërtetojnë që e kanë votuar.

Në përgjigje në ankesë KQZ-ja, ka theksuar se, bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në QKN, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore nr.16/2024 për QKN. KQZ, njofton se procesi i numërimit të votave në QNR është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore nr.14/2024, QNR ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar.

Me tutje ka theksuar se, pala ankuese, ka pretenduar se disa persona kanë votuar për të mirëpo, sipas tij mungojnë votat e tyre. Ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës dhe po ashtu fletëvotimi nuk mund të identifikohet emri i votuesit. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në pritshmërinë dhe deklaratimet e disa personave, duke theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit, duke theksuar se pala ankuese nuk ka ofruar prova në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimet ankimore, përgjigjeve në ankesë, vlerëson se:

Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerëson se pretendimet e kandidatit për Kuvend Komunal të Komunës së Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Ardian Elshani se, është i bindur se është votuar nga votues potencial në regjistrin e votuesve në vendvotimet në Lagjen Bresje në Fushë Kosovë, vendvotimi Shkolla Filllore "Daut Bogujevci, Klasa 0909/04 dhe Klasa 0909/02 duke pretenduar se i ka së paku 50 vota të cilat i mungojnë dhe të njëjtat ja kanë konfirmuar që e kanë votuar votuesit e këtyre vendvotimeve por edhe votues të tjerë të shënuar më numra personal në ankesë, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj si të pabazuara, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohet se ka pasur parregullsi në qendrat të vendvotimit të lartcekura dhe se janë bërë

manipulime të votave, për faktin se ankuesi nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Paneli vlerëson se, deklaratat e bashkangjitura në ankesë nga pala ankuese nuk mund të vërtetojnë faktin se, këta persona kanë votuar ankuesin kur dihet se vota është e fshehtë dhe në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës dhe se nga fletëvotimi nuk mund të identifikohet emri i votuesit, në rastin konkret, paneli, nuk ka mundur të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave në qendrat e votimit të pretenduar të komunës së Fushë Kosovës.

Po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ-së, Paneli vlerëson se, nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruara me ankesë, sepse parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur libër të votimit në vendvotim dhe QKN, formularë ose prova tjera që do mund të mbështesnin pretendimet e tij.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Neni 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Ardian Elshani kandidat për Kuvend Komunal të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është e pabazuar pasi që nuk ka bashkangjitur prova bindëse përkatësisht pretendimi se duhet të ketë rinumërim të votave mbetet vetëm i natyrës deklarative dhe se nuk është mbështetur me asnjë provë që do të dëshmonte pretendimet ankimore. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë, në rastin konkret të provuarit e asaj se duhet të ketë rinumërim, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese, andaj në rrethanat e rastit konkret ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.393/2025, datë 07.11.2025

Kryesuesë e panelit

Hidajete Gashi Alaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.113/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka, kryetar i kolegjit, Muhamet Rexha dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së Ardian Elshani, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Xhevdet Smakiqi, avokat në Prishtinë, për shkak të parregullsive për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.393/2025, të datës 07.11.2025, në seancën e mbajtur më datë 13.11.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Ardian Elshani, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.393/2025, të datës 07.11.2025.

A r s y e t i m i

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZL.Anr.393/2025, të datës 07.11.2025, ka vendosur: "REFUZOHEM e pabazuar ankesa ZL.Anr.393/2025, e datës 05.11.2025, e parashtruar nga Ardian Elshani kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025".

Kundër vendimit të lartpërmendur, Ardian Elshani kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën i konteston rezultatet e përgjithshme të zgjedhjeve, gjegjësisht pretendon se në qendrën komunale të numërimit në fshatin Bardh i Madh, në Shkollën Filllore "Zenel Sahliu" dhe në Komunën e Fushë Kosovës, në lagjen Bresje në Shkollën Filllore "Daut Bogujevci" janë evidentuar parregullsi, pasi që i njëjti pretendon se është votuar nga votuesit potencial në regjistrin e votuesve në vendvotimet në shkollat e lartcekura, por që të njëjtit nuk i janë



numëruar drejtë dhe saktë votat për të cilat ka theksuar se është i bindur se i ka në këto vendvotime duke cekur edhe emra të votuesve të cilët sipas tij ia kanë konfirmuar se kandidatin në fjalë e kanë votuar. Pastaj ka propozuar që Gjykata Supreme të aprovoj si të bazuar faktikisht dhe juridikisht ankesën e tij duke e detyruar QNR në kuadër të KQZ -së, që të bëjë rinumërimin e votave në shkollat e lartcekura.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të Ardian Elshani kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e kandidatit Ardian Elshani, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi i ankimuar i PZAP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se PZAP-i më datë 05.11.2025, ka pranuar ankesën ZL.Anr.393/2025, nga Ardian Elshani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik PDK, në të cilën pretendon se pasi që është njoftuar me rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të 12 Tetorit 2025 nga KQZ-ja është i pakënaqur me rezultatin e numërimit, sepse është i bindur se është votuar nga votues potencial në regjistrin e votuesve në vendvotimet: Lagjen Bresje në Fushë Kosovë, vendvotimi Shkolla Fillore "Daut Bogujevci, Klasa 0909/04 dhe Klasa 0909/02, ku ankuesi pretendon se i ka së paku 50 vota të cilat i mungojnë dhe të njëjtat ja kanë konfirmuar që e kanë votuar votuesit e këtyre vendvotimeve por edhe votues të tjerë të shënuar me numra personal në këtë ankesë, andaj sipas tij është shumë e lehtë që të verifikohen vendvotimet dhe të hapen kutitë e numërimit pasi që është devijuar vullneti i votuesve për të dhe përmes rinumërimit vullneti duhet të kthehet në vendin e vet ku kanë votuar votuesit.

Parashtruesi i ankesës gjithashtu pretendon se në Qendrën e Votimit Bardhi i Madh në shkollën "Zenel Salihu" në rezultatin përfundimtar zgjedhor i kanë dalur vetëm dy vota, kurse së paku 6 votues të vendvotimeve 0904/0, 0904/02 dhe 0904/03 por që sipas ankuesit komisionerët e vendvotimit ose i kanë numëruar gabimisht, ose janë manipuluar në ndikimin e brendshëm dhe të jashtëm për pasojë prapë është devijuar vullneti i qytetarëve, veprime dhe gabime vendimtare që sipas parashtruesit të ankesës nuk e ka fituar mandatin për më pak se 20 vota. Ankuesi ankesën për mungesë të rezultatit të vërtetë e mbështet edhe mbi bazën e takimeve, lobimit dhe përkushtimit të tij politik gjatë fushatës zgjedhore. Andaj, duke u bazuar në këto rrethana, ka kërkuar nga PZAP që të urdhëroj KQZ-në që të bëjë rinumërimin e votave në këto vendvotime. Si prova në ankesë, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografitë e takimeve të datës 03.10.2025 dhe 08.10.2025, me pjesëmarrje masive deri 150 vetë dhe votuesit e numrat personal të tyre që sipas parashtruesit të ankesës janë të gatshëm të vërtetojnë që e kanë votuar.



Në përgjigje në ankesë KQZ-ja, ka theksuar se, bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në QKN, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore nr.16/2024 për QKN. KQZ, njofton se procesi i numërimit të votave në QNR është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore nr.14/2024, QNR ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Me tutje KQZ ka theksuar se, pala ankuese, ka pretenduar se disa persona kanë votuar për të mirëpo, sipas tij mungojnë votat e tyre, dhe se pretendimi i tillë nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës dhe po ashtu fletëvotimi nuk mund të identifikohet emri i votuesit. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në pritshmërinë dhe deklaratimet e disa personave, duke theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit, duke theksuar se pala ankuese nuk ka ofruar prova në kuptim të nenit 117 paragraf 3 të LZP.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimet ankimore, përgjigjeve në ankesë, ka vlerësuar ankesa është e pabazuar, kjo pasi që pretendimet e kandidatit për Kuvend Komunal të Komunës së Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Ardian Elshani se është i bindur se është votuar nga votues potencial në regjistrin e votuesve në vendvotimet në Lagjen Bresje në Fushë Kosovë, vendvotimi Shkolla Filllore "Daut Bogujevci, Klasa 0909/04 dhe Klasa 0909/02, duke pretenduar se i ka së paku 50 vota të cilat i mungojnë dhe të njëjtat ja kanë konfirmuar që e kanë votuar votuesit e këtyre vendvotimeve por edhe votues të tjerë të shënuar më numra personal në ankesë, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj si të pabazuara, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohet se ka pasur parregullsi në qendrat të vendvotimit të lartcekura dhe se janë bërë manipulime të votave, për faktin se ankuesi nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Paneli vlerëson se, deklaratat e bashkangjitura në ankesë nga pala ankuese nuk mund të vërtetojnë faktin se, këta persona kanë votuar ankuesin kur dihet se vota është e fshehtë dhe në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës dhe se nga fletëvotimi nuk mund të identifikohet emri i votuesit, në rastin konkret, paneli, nuk ka mundur të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave në qendrat e votimit të pretenduar të Komunës së Fushë Kosovës.

Po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ-së, Paneli ka vlerësuar se janë të paqëndrueshme pretendimet e parashtruara me ankesë, sepse parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi të votimit në vendvotim dhe QKN, formularë ose prova tjera që do mund të mbështesin



pretendimet e tij. Andaj bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se: "PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht", dhe neni 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: "PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë", ka refuzuar ankesën e kandidatit në fjalë duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të PZAP.

Paneli në fund ka shtuar se ankesa e parashtruar nga Ardian Elshani kandidat për Kuvend Komunal në Fushë Kosovë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është e pabazuar, pasi që nuk ka bashkangjitur prova bindëse përkatësisht pretendimi se duhet të ketë rinumërim të votave mbetet vetëm i natyrës deklarative dhe se nuk është mbështetur me asnjë provë që do të dëshmonte pretendimet ankimore. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë, në rastin konkret të provuarit e asaj se duhet të ketë rinumërim, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese, andaj në rrethanat e rastit konkret ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me refuzimin e ankesës së Kandidatit për Kuvendin e Komunës së Fushë Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) Ardian Elshani, për shkak të parregullsive në ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 12.10.2025, respektivisht parregullsive të pretenduara nga ankuesi lidhur me procesin zgjedhor. Vendimi i PZAP është i drejtë, i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se shkeljet e pretenduara për parregullsi të procesit të votimit në qendrat e votimit në Komunën e Fushë Kosovës vlerësohen të pabazuara.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të kandidatit për Kuvendin e Komunës së Fushë Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) Ardian Elshani, për shkak të parregullsive në ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 12.10.2025, respektivisht parregullsive të pretenduara nga ankuesi lidhur me procesin zgjedhor në dy vendvotime dhe atë në qendrën komunale të numërimit në fshatin Bardh i Madh, respektivisht në Shkollën Filllore "Zenel Salihu" dhe në Komunën e Fushë Kosovës, në lagjen Bresje, në Shkollën Filllore "Daut Bogujevci", mirëpo këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme. Kjo për faktin se PZAP, me rastin e refuzimit të ankesës së ankuesit, si në vendimin e atakuar, me të drejtë ka vlerësuar se nga provat në ankesë dhe ato të bashkangjitura nga ankuesi nuk kanë përkuar me gjendjen faktike e as me shkresat e tjera të lëndës. Në lidhje me këtë, nga shkresat e lëndës



rezulton se, KQZ pas pranimit të kërkesës nga PZAP, ka theksuar se procesi i numërimit të votave në QNR është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr.14/2024, QNR, ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar, dhe se pretendimet e ankuesit se disa persona kanë votuar për të, respektivisht se të njëjtit i mungojnë votat e tyre, pretendimi i tillë nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës dhe po ashtu fletëvotimi nuk mund të identifikohet emri i votuesit, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara dhe se publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit, duke theksuar se pala ankuese nuk ka ofruar prova në kuptim të nenit 117 paragraf 3 të LZP.

Gjykata Supreme vlerëson se nga këto të dhëna, me të drejtë PZAP ka konstatuar se pretendimet e kandidatit për asamble komunale në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Ardian Elshani, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohet fakti me prova konkrete se ka pasur parregullsi në qendra të votimit të cekura në ankesë kjo pasi që kandidati i lartcekur nuk ka bashkangjitur prova bindëse, respektivisht pretendimi se duhet të ketë rinumërim të votave mbetet vetëm i natyrës deklarative dhe se nuk është mbështetur me asnjë provë që do të dëshmonte pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së. Edhe për kolegjin e Gjykatës Supreme është i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP-së se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, ashtu siç parashihet në nenin 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, për çka edhe me të drejtë një ankesë e tillë është refuzuar si e pabazuar.

Kolegji i Gjykatës Supreme, ka vlerësuar të paqëndrueshme pretendimet ankimore të ankuesit që kanë të bëjnë me parregullsitë në vendvotimet në shkollat e lartcekura, kjo pasi që PZAP me vendimin e tij në mungesë të provave konkrete se ka pasur parregullsi në procesin zgjedhor, e duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, me të drejtë ka refuzuar ankesën e kandidatit për asamble komunale në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Ardian Elshani, ndërsa, sipas nenit 118 [Vendimet], të këtij ligji përcaktohet se: *"1. PZAP-ja pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht"*. Sipas nenit 13 paragrafit 2 [Vendimmarrja e PZAP-it], të Rregullores nr.01/2025, të Panelit Zgjedhor për procedurat e parashtrimit dhe vendosjes së ankesave, përcaktohet se: *"PZAP-i aprovon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat në mungesë të provave"*. Mbi këtë bazë kjo gjykatë i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e lartcekura lidhur me parregullsitë në qendrat e vendvotimit, pasi që pretendimet e përshkruara në ankesë, respektivisht emrat e personave të cilët i ka përmendur ankuesi, me pretendim se të njëjtit kanë votuar për të, dhe se ankuesit për të fituar mandatin si asamblist ju kanë dashur më pak se 20 vota, nuk vërtetojnë faktin se të njëjtit të kenë votuar për kandidatin në fjalë, kur kihet parasysh edhe fakti se fshehtësia e votës është e garantuar në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, e po ashtu nga fletëvotimi nuk mund të identifikohet emri i votuesit, që rezulton se deklaratat



(konstatimet) e personave të cekur në ankesë se kanë votuar në qendrat e lartcekura të vendvotimit, nuk janë relevante për vendosje ndryshe në këtë rast.

Gjykata Supreme vlerëson se PZAP duke u bazuar në gjendjen faktike dhe dispozitat të lartcekura, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, nga çka rezulton se vendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe me Rregulloren nr.01/2025, të Panelit Zgjedhor për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave (PZAP), dhe se në mungesë të provave të qëndrueshme me të drejtë është refuzuar ankesa e ankuesit.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara. Kjo për faktin se si të tilla nuk dëshmuuan se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakte të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.113/2025, datë 13.11.2025

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Dyfishçeni i radhës



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-113/2025

FLETËDËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

PZAP - PRISHTINE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fqit, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u odredjeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dana _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes
Razlog odbijanja prijmea

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

Emri i shkresës që dorëzohet:

Naslov pisma koja se dostavlja:

AKT GJYKIM 13.11.25

Numri i shtojcave: _____
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartëpërmendur
më (me fjalë)

Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

17.11.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je
pismo primilo u zamenu)

074
14.12

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duhet shkruar shkaktues ose marrësi nuk e ka vendë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.